

Tiranë, 3.10.2016

LETËR E HAPUR

Drejtuar: *Autoritetit të Medias Audiovizive*

Për dijani: Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë,
Kuvendi i Shqipërisë
Nënkomisionit për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore, Dhunës në Familje, Kuvendi i Shqipërisë
Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
Avokatit të Popullit
Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Unionit të Gazetarëve Shqiptarë
Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë
Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë
Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptare
Shoqata e Gazetarëve për Drejtësi

Lënda: **Organizatrat që mbrojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve, kërkojnë zbatimin e Kodit të Transmetuesve Audiovizivë në lidhje me publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë të përfshirë gratë dhe fëmijët viktimë.**

Të nderuar/a përfaqësues/e të Autoritetit të Medias Audiovizive,

Në emër të aktivisteve për të drejtat të njeriut/të drejtat e fëmijëve që përfaqësojmë, si dhe të personave të abuzuar, një pjesë e te cilëve janë fëmijë e për të cilët shpesh kemi ofruar e ofrojmë mbrojtje ligjore, këshillim, apo integrim në shoqëri, po ndjekim me shqetësim publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë të përfshirë fëmijët viktimë.

Nisur nga rastet e fundit të abuzimeve me të mitur ndajmë me shqetësim mënyrën abuzive të raportimit të këtyre rasteve në media duke çuar në identifikimin e viktimave dhe në riviktimizimin e tyre. Para disa ditësh të gjithë mediat e shkruara dhe ato audiovizive, si dhe

portalet kryesore online kanë paraqitur me detaje rastin e të miturës **F.G 16 vjeç** (strehuar në Qendrën e Emergjencës“Gruaja tek Gruaja“ Shkodër) viktimë e abuzimit nga i ati rreth 1 vit më parë. Shkelja e parimeve etike për hir të sensacionit duke dhënë përshkrim të detajuar të dinamikës së ngjarjes së ndodhur nisur nga emrat e plotë të të miturës dhe abuzuesit (të atit) e deri tek dëshmitë e plota lidhur me ngjarjen, si dhe kur ka ndodhur, emrin e qytetit, fotografi të familjes si dhe histori jetësore i kanë shkaktuar viktimës dëm psikologjik dhe moral.

Fatkeqësisht raste të tilla të cilat ne i trajtojmë janë të shumta e të përsëritura në kohë. Publikimi i këtyre të dhënave është në shkelje të plotë të parimeve dhe legjislacionit shqiptar që sanksionon të drejtat e fëmijëve për të qenë të mbrojtur, për ruajtjen e të dhënave personale, privatësisë dhe konfidencialitetit. Krahas kësaj këto transmetime bien ndesh me standardet dhe praktikatat e transmetimeve audiovizive ku një ndër parimet bazë është respektimi i privatësisë, drejta e personit për mosdiskriminim, për konfidencialitet vetjak e familjar.

Duke marrë shkas nga ngjarja tragjike e abuzimit të kësaj vajze të mitur dhe shumë të tjerëve si edhe duke u bazuar në Pikën 5.1 të Kodit të Transmetuesve Audiovizivë: *“Ofruesit e shërbimit mediatik audiovizivë (OSHMA-të) duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale”*, dënojmë ashpër transmetime të tilla televizive e kërkojmë nga Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA):

- Të respektohen parimet etike në transmetimin e lajmeve/emisioneve që kanë të bëjnë me fëmijët të mitur duke eliminuar transmetimin me zë dhe me figurë të ngjarjes që mundëson identifikimin e viktimës/familjarëve;
- Të shmangen imazhet e papërshtatshme të cilat mund të jenë me pasoja psikologjike kryesisht tek fëmijët, viktima të abuzimit;
- U kërkojmë mediave të bëhen partnerë në parandalimin e abuzimeve me fëmijët duke ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe parandalimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore;
- Të bëhen amendimet e nevojshme në ligj për marrjen e masave shtrënguese ligjore në rastet kur media bëhet promotore e dhunës duke u kthyer në një mjet kërcënues me karakter sensacional.

Ju falenderojmë paraprakisht për angazhimin Tuaj për të konsideruar kërkesat tona në mbrojtje të jetës, të drejtave njerëzore dhe sigurisë e dinjitetit të fëmijëve dhe grave që janë viktima të dhunës.

Sinqerisht,

1. Majlinda Angoni, Drejtore Ekzekutive, Gruaja tek Gruaja, Shkodër;
2. Endrit Uligaj, Përfaqësues i Zyrës për Djem dhe Burra, Shkodër;
3. Brikena Puka, Drejtore Ekzekutive, Qendra Psiko-sociale “Vatra”, Vlorë;
4. Shpresa Banja, Drejtore Ekzekutive, Forumi Gruas Elbasan;
5. Bajana Çeveli, Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës;
6. Iris Luarasi, Drejtore Ekzekutive, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza;
7. Bledar Zeneli, Përfaqësues i Zyrës për Djem dhe Burra, Tiranë;
8. Mirela Arqimandriti, Drejtore Ekzekutive, Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim;
9. Eleni Jajçari, Drejtore Ekzekutive, Shoqata “Unë Gruaja”, Pogradec;
10. Bukurie Begu, Shoqata “Agritra Vizion”, Peshkopi;
11. Entela Gjoni, Drejtore Ekzekutive, Shoqata “Jona”, Sarandë;
12. Ines Leskaj, Drejtore Ekzekutive, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN).